**20150612175**

# L I GJ
# PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KULTURË

Neni 1

Në Ligjin për kulturë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 31/98, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13 dhe 44/14 ), në nenin 91-a pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Gjobë në shumë prej 600 deri në 700 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alineja 5 të këtij neni personit fizik".

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (5) dhe (6).

Neni 2

Në nenin 113 paragrafi (1) fjalët: "në afat prej dy vitesh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji" zëvendësohen me fjalët: "në të cilin është sistemuar në ditën e fillimit me zbatim të këtij ligji, në afat prej një viti nga dita e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.